



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Primitar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivety		12.06	3	viti god year
		202		
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKPUSHQK	4715/2023		1/7	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.685/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtar, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.685/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga grup ankuesish:

e regjistruar në Këshill në emër të ankuesit të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat me adresë të Komunën e Podujevës, kundër organit të punësimit/Komuna e Podujevës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 09.06.2023, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Aprovohet si e bazuar** ankesa me numër A.nr.685/2023 e datës 28.04.2023 e parashtruar nga grupi i ankuesve të evidentuar si në preambulë, e regjistruar në Këshill në emër të ankuesit të cilët me autorizim i përfaqëson Avokat

**II. Detyrohet** Komuna e Podujevës të bëjë kompensimin e pagesave për ankuesit në shumën e përgjithshme prej 415,340.15€, apo për secilin ankues veç e veç si në vijim:

prej 2,595.48 €;	në shumën prej 2,674.33 €;	në shumën prej 2,280.98 €;
në shumën prej 2,428.66 €;	në shumën prej 1,743.21 €;	në shumën prej 2,599.25 €;
në shumën prej 2,428.66 €;	në shumën prej 1,343.80 €;	në shumën prej 2,579.72€;
në shumën prej 2,576.81€;	në shumën prej 2,556.51 €;	në shumën prej 3,080.06€;
në shumën prej 2,277.19 €;	në shumën prej 3,045.01€;	në shumën prej 2,424.11€;
në shumën prej 2,277.19 €;	në shumën prej 718.34€;	në shumën prej 3,370.26 €;
në shumën prej 2,627.03 €;	në shumën prej 3,138.94 €;	në shumën prej 2,876.36 €;
në shumën prej 2,436.51 €;	në shumën prej 2,062.85€;	në shumën prej 2,663.83€;
në shumën prej 2,651.70€;	në shumën prej 3,216.69 €;	në shumën prej 1,612.19€;
në shumën prej 2,646.44 €;	në shumën prej 2,651.70€;	në shumën prej 2,674.09€;
në shumën prej 2,437.75€;	në shumën prej 2,588.58€;	në shumën prej 2,829.18 €;
në shumën prej 1,675.85€;	në shumën prej 2,437.75 €;	në shumën prej 2,621.88€;
në shumën prej 2,073.89€;	në shumën prej 2,437.75 €;	në shumën prej 2,584.23€;
në shumën prej 2,654.58€;	në shumën prej 2,853.48€,	në shumën prej 2,614.07€;
në shumën prej 1,739.86€;	në shumën prej 2,601.78€;	në shumën prej 2,588.51€;
në shumën prej 2,926.68€;	në shumën prej 2,853.48€,	në shumën prej 2,862.59 €;
në shumën prej 2,616.29 €;	në shumën prej 2,666.22€,	Gërguri në shumën prej 2,616.29 €;
në shumën prej 2,431.40€;	në shumën prej 2,666.22€,	në shumën prej 2,110.88€;
në shumën prej 1,578.54€;	në shumën prej 2,666.22€,	640.34€;
në shumën prej 3,231.20€;	në shumën prej 2,666.22€,	prej 2,639.83€;
në shumën prej 2,616.51€;	në shumën prej 2,595.48€;	në shumën prej 3.580.44 €;
në shumën prej 2,882.65 €;	në shumën prej 2,595.48€;	në shumën prej 2,606.00 €;
në shumën prej 2,631.79€;	në shumën prej 2,595.48€;	në shumën prej 2,631.79€;



2,648.07€; në shumën prej 2,901.51€; në shumën prej 2,437.75 €;  
 në shumën prej 2,326.60 €; në shumën prej 1,364.19€; në  
 shumën prej 2,015.61€; në shumën prej 1,264.47€; në shumën prej  
 2,657.60€; në shumën prej 2,496.86€, në shumën prej 3,116.25€;  
 në shumën prej 4,068.77€; në shumën prej 4,250.38€; në shumën prej  
 3,045.53€, në shumën prej 2,400.32€; në shumën prej 3,002.02€;  
 në shumën prej 2,765.45€; në shumën prej 3,000.10€; në shumën  
 prej 2,924.02€; në shumën prej 1,631.05€; në shumën prej  
 3,036.32€; në shumën prej 1,463.02€; në shumën prej 3,305.96€;  
 në shumën prej 2,284.78€; në shumën prej 2,844.91€;  
 në shumën prej 2,790.88€; në shumën prej 668.60€; në shumën  
 prej 3,573.92€; në shumën prej 2,657.68€; në shumën prej 1,449.07€;  
 në shumën prej 1.364.19€; në shumën prej 1,367.22€; në  
 shumën prej 2,419.56€; në shumën prej 2,261.07 €; në shumën prej  
 2,196.76 €; në shumën prej 2,694.05€; në shumën prej 3,684.29€;  
 në shumën prej 2,615.03€; në shumën prej 2,648.07€;  
 në shumën prej 2,652.33€; në shumën prej 2,592.51€, në shumën  
 prej 2,863.77€; në shumën prej 2,423.21€; në shumën prej 2,315.71€;  
 në shumën prej 2,458.98€; në shumën prej 3,212.99€; në  
 shumën prej 2,437.75€, në shumën prej 2,787.16€; në shumën prej  
 2,428.66€; në shumën prej 2,577.83€; në shumën prej 2,433.21€;  
 në shumën prej 3,112.25€; në shumën prej 2,653.33€;  
 në shumën prej 1,367.64€; në shumën prej 2,514.76€; në  
 shumën prej 2,534.43€; në shumën prej 3,180.47€; në shumën prej  
 803.85€; në shumën prej 2,606.14€; në shumën prej 2,674.98€;  
 në shumën prej 2,606.14€; në shumën prej 2,269.61€; në shumën prej  
 2,673.05€, në shumën prej 3,305.20€; në shumën prej 3,468.01€,  
 në shumën prej 2,621.78€; në shumën prej 2,674.33€; në shumën  
 prej 2,895.22€; në shumën prej 3,183.82€; në shumën prej 2,674.33€;  
 në shumën prej 2,658.58€; në shumën prej 2,658.58€;  
 në shumën prej 2,851.18€; në shumën prej 2,907.36€; në  
 shumën prej 3,231.20€; në shumën prej 2,642.81€; në shumën prej  
 3,192.47€; në shumën prej 2,851.18€; në shumën prej 2,914.09€;  
 në shumën prej 2,642.81€; në shumën prej 3,136.26€; në shumën  
 prej 3,293.17€; në shumën prej 3,123.49€; në shumën prej 3,675.01€;  
 në shumën prej 2,827.62€; në shumën prej 2,587.80€; në  
 shumën prej 3,322.90 €; në shumën prej 3,137.97€; në shumën prej  
 2,679.60€; në shumën prej 3,231.20€; në shumën prej 2,695.37€;  
 në shumën prej 3,445.26€; në shumën prej 2,958.12€; €  
 në shumën prej 1,971.69€; në shumën prej 2,243.07 €; në shumën prej  
 2,016.66€; në shumën prej 2,428.49€; në shumën prej 1,421.42€;  
 në shumën prej 2,699.61€; në shumën prej 2,777.54€ dhe  
 në shumën prej 2,637.55€, të gjitha këto në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.



II. **Obligohet** Kryetari i Komunës së Podujevës që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

### A r s y e t i m

Ankuesit e përcaktuar sikurse në preambulën e këtij vendimi, nëpërmjet përfaqësuesit të tyre të autorizuar me datën 28.04.2023, kanë parashtruar ankesë me numër të protokollit 3907/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është plotësuar me datë 08.06.2023 përmes parashtrësës me numër protokollit:4623/2023, kundër heshtjes administrative të Komunës së Podujevës ndaj kërkesës së parashtruar me datës 31.01.2023 nga ankuesit për Kryetarin e Komunës së Podujevës me qëllim të kompensimit të pagesave në emër të shtesave të aprovuara për kompensimin e pagës së 13-të, pagës përcjellëse në pension, shpërblimin jubilarë dhe pagesën për ushqim ditorë për ditët e pranisë në punë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datën 05.05.2023, ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesve në Komunën e Podujevës. Me datën 16.05.2023 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Podujevës me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritator ka administruar këto prova: Ankesën me Nr.3907/2023 të datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me autorizimin e bashkangjitur të datës 18.10.2022; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Podujevës i datës 08.11.2022 me shifër: Nr.02–116/01-0093005/22; Kërkesën e datës 18.11.2022 e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës; Kërkesën e datës 07.12.2023 e Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës; Listën e datës 07.12.2022 të miratuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës dhe Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, Kërkesën e ankuesve të datës 30.01.2023 parashtruar në Komunën e Podujevës; Fltekthesën e postës:2860856; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 01.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 05.05.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 11.05.2023 me të gjitha aktet e emërimit për të gjithë ankuesit të përcaktuar sikurse në këtë vendim; Parashtrësën e ankuesve të datës 08.06.2023; Aktgjykimin me numër A.nr.1994/22, të datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative; Vendimin e Këshillit A.nr.184/2022 të datës 10.10.2022; Vendimin e Këshillit të datës 30.11.2022 për korrigjimin e Vendimit A.nr.184/2022 dhe Mendimin Juridik Nr.42/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesve e cila në Këshill është e regjistruar në emër të ankuesit me numër A.nr.685/2023 e datës 28.04.2023 është e bazuar, sepse:



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, thekson faktin se duke vepruar sipas Aktgjykimit me numër A.nr.1994/22 i datës 06.09.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, kishte shqyrtuar ankesën e ankuesve të datës 10.07.2020 lidhur me kërkesën e tyre për kompensimin e pagesave në emër të shtesave për kompensimin e pagës së 13-të, pagës përcjellëse në pension, shpërblimin jubilarë dhe pagesën për ushqim ditorë për ditët e pranisë në punë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ndërsa me datë 10.10.2022 Këshilli kishte nxjerrë Vendimin A.nr.184/2020 me numër protokolli:6050/2023 i plotësuar dhe korrigjuar me datë 30.11.2022, përmes të cilit vendim ishte aprovuar ankesa e ankuesve e datës 10.07.2020, ndërsa lënda ishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i punësimit.

Kryetari i Komunës së Podujevës me datë 08.11.2022 me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit nxjerrë vendimin me shifër: Nr.02—116/01-0093005/22 përmes të cilit zotohet se do të respektojë vendimarrjen nga ana e Këshillit, ndërsa Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore sipas obligimeve ligjore dhe pikëpamjeve juridike të vendimit të Këshillit, Ligjit Nr.03/L-212 i Punës dhe Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive të Kosovës, pas rishqyrtimit dhe rivendosjes, me datë 07.12.2022 harton listën me kalkulimin e shumës monetare në vlerën e përgjithshme prej 415,340.15 Euro apo për secilin ankues veç e veç të përcaktuar si në pikën II të dispozitiv të këtij vendimi në emër të kompensimit të pagës së 13-të, pagës përcjellëse në pension, shpërblimin jubilarë dhe pagesën për ushqim ditorë për ditët e pranisë në punë, listë kjo e cila është miratuar nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe është aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës. Mirëpo nga shkresat e lëndës është konstatuar fakti se ankuesit nuk kanë realizuar kompensimin e përcaktuar në listën e datës 07.12.2023, prandaj përmes përfaqësuesit të autorizuar me datë 31.01.2023 të njëjtit i janë drejtuar Kryetarit të Komunës së Podujevës me njoftimin se kompensimet e përcaktuara nuk janë ekzekutuar, gjegjësisht me kërkesën që i njëjti në cilësi të titullarit të institucionit të ndërmarre veprimet e nevojshme për realizimin e kompensimit në fjalë.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesve për miratimin në heshtjes ngase Komuna e Podujevës ka heshtur ndaj kërkesës së tyre të datës 31.01.2023, ka analizuar dispozitat e aplikuara ligjore të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 125 paragrafi 1 dhe nenin 127 paragrafi 4 ku përcaktohet se: "125.1. Përpos nëse është paraparë ndryshe me ligj, ankesa mund të parashtrohet kundër një akti administrativ apo ndaj mosveprimit të organit publik brenda afatit të përcaktuar për përfundimin e procedurës administrative (në vijim: "heshtja administrative") dhe 127.4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ." ndërlidhur me nenin 98 paragrafi 1 dhe 2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: "1. Procedura administrative nisur sipas kërkesës, do të përfundojë sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se sa afati i përcaktuar me ligj të veçantë për atë lloj procedure. 2. Në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj.", Kolegji i Këshillit ka ardhur në përfundimin se Komuna e Podujevës ka heshtur ndaj kërkesës së ankuesve të datës 31.01.2023, pasi që nga shkresat e lëndës, gjegjësisht fletë kthesës së postës me numër:28620856 dëshmohet se kërkesa në fjalë nga Komuna e Podujevës është pranuar me datë 01.02.2023, nga rrjedh se sipas dispozitave ligjore të përcaktuara



me lartë e njëjta ka qenë e obliguar që të vendos brenda afatit prej 45 ditësh, e që rezulton të jetë data 17.03.2023, nga rrjedh se ankesa e ankuesve e parashtruar në Këshill me datë 28.04.2023 kundër heshtjes administrative është bërë në pajtueshmëri me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit vlerëson se Komuna e Podujevës sipas dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ka qenë e obliguar që të nxjerrë akt administrativ përmes të cilit do të ri konfirmonte apo manifestonte vullnetin e institucionit në cilësi të organit publik lidhur me të drejtën e konfirmuar paraprakisht për kompensimin e shtesave për ankuesit sipas listës së datës 07.12.2022, duke dhënë arsyet e saj për mosekzekutimin e pagesave sipas kërkesës së datës 07.12.2022 me shifër 04-400/04-0100464/22 drejtuar Thesarit të Kosovës nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës, apo duke përcaktuar një afat kohor se e drejta e dhënë në emër të kompensimit do të fillojë dhe mbarojë me ekzekutimin e mjeteve financiare brenda një afati apo periudhe kohore të caktuar.

Prandaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, analizimit të dispozitave ligjore dhe konstatimit të gjendjes faktike, si dhe duke marrë për bazë Mendimin Juridik Nr.42/2023 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 27.02.2023 lidhur me kompensimet materiale që për bazë kanë Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive të Kosovës ndërlidhur me aplikimin e dispozitave të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, duke marrë për bazë Vendimin e Këshillit A.nr.184/2022 të datës 10.10.2022 i korrigjuar dhe plotësuar me datë 30.11.2022, dhe po ashtu Vendimin me shifër: Nr.02 – 116/01-0093005/22 i datës 08.11.2022 i Kryetarit të Komunës së Podujevës, Listën e datës 07.12.2022 me kalkulimin e shumës monetare për kompensimin e ankuesve në vlerën e përgjithshme prej 415,340.15 € euro të nënshkruar nga Menaxheri i Njësisë së Burimeve Njerëzore dhe aprovuar nga Drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa të Komunës së Podujevës, kërkesën e datës 18.11.2022 dhe ate të datës 07.12.2022 përmes shkresës me shifër: 04-400/04-0100464/22 të Drejtorit të Drejtorisë për Buxhet dhe Financa i Komunës së Podujevës përmes së cilës i drejtohet Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës për ekzekutimin e kompensimeve të përcaktuara për ankuesit dhe duke u mbështetur në nenin 3 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankuesve e datës 28.04.2023 e parashtruar në Këshill është e bazuar ngase rrethanat juridike nuk kanë ndryshuar, gjegjësisht nga shkresat e pranuar nga Komuna e Podujevës me datë 11.05.2023 dhe shifër:13-016/01-0032471/23 të dërguar përmes Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore, nuk është provuar e kundërta e gjendjes faktike të konstatuar si më lartë, gjegjësisht konfirmohet fakti se Komuna e Podujevës qëndron pranë vullnetit për përmbushjen e obligimeve ligjore respektivisht kompensimin e ankuesve ngase e njëjta nuk është tërhequr nga kërkesa e datës 07.12.2022 me shifër: 04-400/04-0100464/22 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Thesarit të Kosovës.

Prandaj, duke marr për bazë konstatimet e dhëna si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi, ankesa e ankuesve është e bazuar, dhe mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit duke u mbështetur në nenin 21 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ku përcaktohet se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës. 2. Zbatimi i vendimit duhet të bëhet brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të*



vendimit të Këshillit" e obligon Komunën e Podujevës që ankuesve tua bëjë kompensimin pagesave në shumën e përgjithshme prej 415,340.15€, apo për secilin ankues veç e veç sikurse përcaktohet në pikën II të dispozitivit në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Mbështetur në nenin 17 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative palët në procedurë, gjegjësisht ankuesit sipas autorizimit të bashkangjitur me rastin e parashtrimit të ankesës së datës 28.04.2023 kanë caktuar përfaqësuesin e autorizuar i cili është përcaktuar si në pikën I të dispozitivit dhe ka mandatin të veprojt për dhe në emër të ankuesve dhe të njëjtit në emër të ankuesve i dërgohet ky vendim.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.2 dhe 1.4 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafin 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.685/2023

Çlirim ZEKA  
  
Procesmbajtës

Eshref SHABANI  
  
Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Përfaqësuesit të ankuesve,
- Kryetarit të Komunës së Podujevës;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Podujevës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.